3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Furnizim me artikuj ushqimore
1. Njoftimi për kontrate i datës 04.11.2024
2. Dosja e tenderit e datës 04.11.2024
3.Vendimi për refuzimin e kërkesës për ryshqirtim i dates 15.11.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

/

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:
Neni 1 – Qëllimi
Neni 6 – Ekonomiciteti
Neni 7 – Barazia në trajtim/ jo-diskriminimi
Neni 28 - Specifikimet teknike
Neni 52 - Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 59 – Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave
Neni 60 – Kriteret e dhënies
Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Parimet e Prokurimit Publik

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët
Neni 97 Shkeljet e Renda.
Udhëzuesi për Prokurim Publik nr. 001/2023
Neni 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Të pakënaqur me njoftimin B05 të datës 04.11.2024 mbi dosjen e tenderit të titulluar: "Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut", për aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me Qokolata për dhuruesit vullnetarë të gjakut" me nr. të prokurimit: 71700-24-11602-1-2-1, në afatin ligjor sipas nenit 108/A të Ligjit për Zgjidhjen Preliminare të Mosmarrëveshjeve, ne besojmë se kushtet e vendosura nuk janë pa qëllim apo qëllime të veçanta.

SHOQËRI ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUARA DAUTI KOMERC SH.P.K. SHKUP

Ankesë

Kompania Dauti Komerc SHPK është e pakënaqur me kushtet e dosjes së tenderit, veçanërisht me ato të Seksionit 2, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), dhe konkretisht me pikat 9.1 dhe 9.2, ku kërkohet autorizim nga prodhuesi ose, në rastet kur blerja bëhet nga distributori, autorizim nga distributori dhe autorizim të distributorit nga prodhuesi. Gjithashtu, kompania është e pakënaqur me Aneksin 1, Specifikimet Teknike të Detyrueshme, ku specifikimet teknike janë përshkruar për një produkt të caktuar, i cili prej vitesh është shpallur fitues i tenderit, por nuk është pjesë e tregut komercial të Kosovës dhe përdoret kryesisht vetëm për këtë tender.

Pas analizës së kategorisë së çokollatave në tregun e Kosovës, kemi konstatuar se specifikimet e vendosura nuk i plotëson asnjë tjetër çokollatë, përfshirë edhe kompanitë me brendet më të njohura ndërkombëtare si: Milka, Schogetten, Krash, Swiss Alps, Mauxion, Kandit, etj., të prodhuara në vendet Evropiane. Këto kritere i plotëson vetëm çokollata me emrin Sintagma, e prodhuar nga Vitaminka AD në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu, çmimi i kontraktuar në kontratën aktuale nuk është çmim konkurrues, duke qenë 0.99 euro, çmim me të cilin mund të ofrohen të gjitha brendet e lartpërmendura.

Ne kërkojmë vetëm atë që na mundëson Ligji për Prokurimin Publik të Kosovës, Nr. 04/L-042, konkretisht në bazë të neneve 7 dhe 9: Barazi dhe Jo-Diskriminim mes operatorëve ekonomikë.

Pretendimi ankimor :1

Ashtu siç e kemi cekur në hyrje, kërkojmë largimin e kushtit të (FDT), dhe konkretisht të pikave 9.1 dhe 9.2, ku kërkohet autorizim nga prodhuesi ose, në rastet kur blerja bëhet nga distributori, autorizim nga distributori dhe autorizim të distributorit nga prodhuesi. Ky kusht shërben vetëm për rregullime të "planeve" dhe ka si qëllim të mbetet opsioni i vetëm i mundshëm për aplikim në këtë tender, shumë specifik, i cili favorizon vetëm produktin "Sintagma" të prodhuesit Vitaminka A.D. nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Për largimin e këtij kushti, kemi kërkuar sqarim të dosjes me datën 07.11.2024, dhe po atë ditë kemi marrë përgjigje negative, pasi sipas AK bëhet fjalë për një pjesë të ndjeshme, duke u bazuar në faktin që bëhet fjalë për dhurues të gjakut. Kjo nuk ka ndonjë vlerë praktike dhe nuk siguron asnjë përfitim për dhuruesit e gjakut, por ka për qëllim të favorizojë një operator ekonomik.

Nëse do të mendohej në mënyrë reale për interesin e dhuruesve të gjakut, ata do të mund të merrnin çokollata nga një markë ndërkombëtare dhe jo një produkt që është shumë i padëshiruar në treg, dhe që nuk ka shitje të mjaftueshme për t'u ofruar në tregun komercial të Kosovës.

Për arsyet e lartpërmendura, kërkojmë që të mendohet realisht për interesat e dhuruesve të gjakut, për financat publike, dhe për barazi dhe jo-diskriminim mes operatorëve ekonomikë. Ky kusht, i cili është i panevojshëm dhe tendencioz, duhet të largohet menjëherë.

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR DAUTI KOMERC SH.P.K. FERIZAJ

Pretendimi ankimor :2

Siç e kemi theksuar edhe në hyrje, jemi të pakënaqur me Aneksin 1, Specifikimet Teknike. Pas analizës së tregut të çokollatave dhe shqyrtimit të çdo produkti të mundshëm në treg, rezulton se asnjë çokollatë që mund të blihet në Kosovë nuk i përmbush kushtet e vendosura në specifikimet teknike. E vetmja çokollatë që i përshtatet këtyre kushteve është "Sintagma," e prodhuar nga Vitaminka A.D. në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe kjo çokollatë, siç kemi theksuar më parë, nuk është e pranishme në tregun komercial të Kosovës.

Gjithashtu, për këtë produkt, distributori për Kosovë është kompania Vitaminka Trade, e cila ofron autorizim ekskluzivisht vetëm për kompaninë Pashtriku. Për këtë arsye, Pashtriku është aktualisht fitues i kontratës dhe ka një avantazh të padrejtë ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë. Çmimi i këtij produkti është 0.80 euro, ndërsa në kontratën e lidhur çmimi është 0.99 euro për njësi. Duke qenë i sigurt se nuk ka konkurrencë, ky operator ekonomik (OE) e ka vendosur këtë çmim më të lartë, gjë që është mundësuar nga vetë AK. Në një sasi prej 30,000 copë, kjo rezulton në një shpenzim të panevojshëm të financave publike prej 5,700 eurosh më shumë, që bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin e ekonomisë dhe eficiencës.

Sa i përket çmimit real të produktit, ne e vërtetojmë këtë përmes faktit se kemi një kompani në Maqedoni, Dauti Komerc SH.A. Shkup, përmes së cilës e blejmë këtë produkt drejtpërdrejt nga prodhuesi Vitaminka AD për një çmim prej 0.78 euro.

Të gjitha këto barriera të lartpërmendura janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe me çdo nen të tij. Kërkojmë që specifikimet teknike të reformulohen për të mundësuar një konkurrencë të hapur dhe mundësi të barabartë për çdo operator ekonomik të interesuar për pjesëmarrje.

Gjithashtu, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të dëshmojë në bazë të cilave analiza ose vërtetime shkencore ka arritur në përfundimin se këto specifikime teknike që i përkasin vetëm çokollatës Sintagma janë të preferuara për dhuruesit e gjakut dhe në bazë të cilave fakte çdo çokollatë tjetër nuk është e përshtatshme. Ky pohim është i pabazuar dhe i pabesueshëm pa prova të qarta.

Kemi informata se as në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Qendrën Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut, kjo çokollatë nuk u ofrohet dhuruesve të gjakut. Ky fakt mund të vërtetohet me kontratë, pasi kontratat janë publike.

Të gjitha këto çojnë në përfundimin e qartë se kushtet dhe specifikimet teknike të vendosura në këtë tender janë tendencioze dhe në kundërshtim të plotë me parimet e konkurrencës së lirë dhe të barazisë. Për këtë arsye, kërkojmë me ngulm që të bëhen korrigjimet e nevojshme për të siguruar një proces të drejtë dhe të ligjshëm.

SHOQERI ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR DAUTI KOMERC SH.P.K. FERIZAJ

Pretendimi ankimor: 3

Në një pyetje të mëparshme, ju jeni përgjigjur : "Secilit dhurues i ofrohet çokollatë dhe lëng pas dhurimit të gjakut, për ta mbajtur trupin e hidratuar dhe në vlera normale, nivelin e sheqerit pas dhurimit të gjakut.".Megjithatë, nuk është e sqaruar se në bazë të cilit ligj ose rregullore është dhënë kjo përgjigje, pasi në bazë të **Ligjit Nr. 06/L-042 për Gjak dhe Përbërës të Gjakut**, mbrojtja dhe kujdesi ndaj dhuruesve janë prioritet, por rekomandimet për ushqimin specifik nuk janë përfshirë drejtpërdrejt në ndonjë nen të këtij ligji.

Po ashtu, nuk ka rregullore të posaçme që përcakton përmbajtjen ushqyese të çokollatës për dhuruesit e gjakut, por ka udhëzime të përgjithshme të bazuara në rekomandime mjekësore.

Kriteret kryesore ushqyese për çokollatën për dhuruesit e gjakut janë:

- **Kalori të larta**: Dhurimi i gjakut ul përkohësisht nivelet e sheqerit në gjak, prandaj çokollata me 500-600 kcal për 100 g ndihmon në rikthimin e energjisë.
- **Karbohidrate**: Sheqernat e thjeshta, si glukoza dhe sukroza, ndihmojnë në rikuperimin e shpejtë të energjisë. Çokollata përmban zakonisht 50-60 g karbohidrate për 100 g.

Burimet e udhëzimeve: Organizata Botërore e Shëndetësisë, Kryqi i Kuq Amerikan dhe Shërbimet Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut rekomandojnë produkte të pasura me kalori dhe karbohidrate për të ndihmuar në rikuperimin pas dhurimit të gjakut.

Aktualisht, në rregulloret e Bashkimit Evropian për dhurimin e gjakut, të përfshira në Direktivën 2002/98/EC dhe Direktivën 2004/33/EC, nuk specifikohen vlerat ushqyese ose përbërësit nutritivë që duhet të ofrohen për dhuruesit e gjakut.

Duke u bazuar në faktet e cekura më lart, kërkojmë që specifikimet teknike të rishikohen dhe të përshtaten sipas tyre, duke u fokusuar vetëm në vlerat energjetike (kcal) dhe karbohidratet. Ky ndryshim është i domosdoshëm për të siguruar që dhuruesit e gjakut të kenë mundësinë të provojnë produkte të reja, të cilat do të përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara, duke respektuar gjithashtu parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit.

Në këtë mënyrë, operatorët ekonomikë do të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke ofruar mundësi për konkurrencë të shëndetshme, në përputhje me ligjet në fuqi dhe kërkesat që LPP e garanton. Ky proces do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të të gjithë palëve të interesuara, si dhe do të kontribuoni në një proces transparent dhe të drejtë.

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR DAUTI KOMERC SH.P.K. FERIZAJ

Pretendimi ankimor : 4 (Përgjigjur Vendimit për refuzimin e kërkesës për ryshqirtim i dates 15.11.2024)

Në bazë të vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK më 15.11.2024, kemi marrë një vendim që nuk ka bazë ligjore dhe është formulua në një mënyrë që synon të mbrojë vetëm interesat e AK-së, pa u mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP).

Në këtë vendim, AK thotë se ka ofruar dy mundësi për OE-të (operatorët ekonomikë) që janë të interesuar për autorizim: autorizim nga prodhuesi ose nga distributori. Megjithatë, është e qartë që këto mundësi janë të kufizuara, pasi produktet e kërkuara janë të disponueshme vetëm nga një distributor në Kosovë, që do të thotë se nuk ka mundësi të tjera për furnizim nga prodhues të ndryshëm. AK është në dijeni të kësaj situate dhe e di që kjo e drejtë është e kufizuar nga specifikimet teknike të tenderit, të cilat nuk janë të disponueshme nga asnjë distributor tjetër i qokolladave në Kosovë.

Në arsyetimin e dytë, AK thotë se specifikimet teknike janë të drejtë e plotë e AK-së dhe se nuk diskriminojnë asnjë OE. Megjithatë, është e qartë se, në praktikë, AK favorizon vetëm një OE dhe një produkt të caktuar, duke shkelur parimin e konkurrencës së barabartë dhe duke kufizuar mundësitë për pjesëmarrës të tjerë.

AK gjithashtu thotë se asnjë OE nuk mund të detyrojë AK-në për të pranuar kushtet e tij, duke e paraqitur si "ambicie" të operatorëve ekonomikë kërkesën për kushte më të mundshme për konkurrencë. Mirëpo, kjo është e gabuar, pasi është AK që po imponon kushte të tilla që favorizojnë vetëm një OE dhe një produkt, duke kufizuar mundësitë e konkurrencës dhe duke e bërë procesin të padrejtë. Qëllimi i kërkesave tona është që të mundësohet pjesëmarrja e një numri të madh operatorësh ekonomikë dhe të ofrohen mundësi të barabarta konkurruese.

Në vendim, AK thekson se qëllimi i tij është mbrojtja e dhuruesve të gjakut dhe se ata janë të shenjtë për AK-në. Megjithatë, duke parë kushtet dhe specifikimet e vendosura, është e qartë se qëllimi i vërtetë është të favorizohet vetëm një kompani dhe një produkt i vetëm. Po të kishte vërtet për qëllim mbrojtjen e dhuruesve të gjakut, AK do të kishte mundësuar që dhuruesit të përfitonin produkte më cilësore, nga brende ndërkombëtare të njohura.

Ne, si OE, nuk kemi asnjë qëllim për të dëmtuar dhuruesit e gjakut, përkundrazi, edhe ne jemi banorë të Republikës së Kosovës dhe dhurojmë gjak, ashtu si shumë nga punonjësit tanë dhe familjarët. Kërkesat tona kanë për qëllim që dhuruesit të kenë mundësi të përfitojnë produkte më cilësore dhe të ndryshme, dhe jo të kufizohen në mundësi të pakta që favorizojnë një produkt të vetëm.

Në përfundim, nga të gjitha arsyetimet e dhëna në këtë vendim, është e qartë se AK ka krijuar një situatë që favorizon një ofertë dhe një produkt të vetëm, duke kufizuar konkurrencën dhe duke shkelur parimet e LPP-së. Kjo tregon se ka një tendencë të qëllimshme për të krijuar kushte të padrejta dhe të mbyllura për operatorët ekonomikë.

DAUTI KOMERC SH.P.K. FERIZAJ

Ligje dhe Rregullore të Shkelura:

- Ligji për Prokurim Publik i Republikës së Kosovës, në nenin që rregullon trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, është shkelur përmes mospranimit të produkteve që përmbushin ose tejkalojnë kërkesat minimale teknike.

- Rregulloret e Komisionit Rregullator për Prokurim Publik për standardizimin dhe vlerësimin e saktë të ofertave janë shkelur përmes kërkesave të papërshtatshme për mostra dhe mosrespektimit të ofertave që tejkalojnë specifikimet minimale.

Dauti Komerc SH.P.K kërkon rishqyrtim të këtij vendimi dhe një vlerësim objektiv bazuar në ligjet dhe rregulloret e Prokurimit Publik, duke respektuar të drejtat e barabarta për të gjithë operatorët dhe duke eliminuar çdo formë të trajtimit të njëanshëm.

Bazuar në të gjitha këto fakte që ofruam konsiderojmë që ka:
Shkeljet e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,
Shkelja e Nenit 1.
Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në Nenin 1 Qëllimi, paragrafi 1: "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla." Dhe paragrafi 3 "Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji."

Shkelje e të gjitha Parimeve të LPP-së - Shkelja e Nenit 6 dhe Nenit 7

*Neni 7, paragrafi 1 i Ligjit për Prokurim Publik (LPP) thekson se: "Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente."

Në këtë rast, ne nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë. Kjo sjell në vëmendje një trajtim jo të barabartë, Kjo praktikë përbën shkelje të qartë të parimeve të barazisë dhe transparencës të përcaktuara në LPP.

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR DAUTI KOMERC SH.P.K. FERIZAJ

Shkelja e Nenit 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Në veçanti, **Paragrafi 4** i Nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik përcakton se: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Shkelja e Nenit 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Sipas **Paragrafit 1** të Nenit 60 të Ligjit për Prokurim Publik, thuhet se: "Autoriteti kontraktues do t'ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët."

Sipas Nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik,
Autoritetet kontraktuese duhet të përdorin specifikime teknike të qarta dhe të arsyeshme që janë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e kontratës.
Ky nen është shkelur në tërësi, pasi specifikimet teknike të vendosura i përkasin vetëm një produkti të caktuar dhe nuk ofrojnë mundësi për konkurencë të barabartë. Kjo kufizon mundësinë e ofertimit nga operatorët e tjerë ekonomikë dhe nuk siguron një proces të drejtë prokurimi, në kundërshtim me parimet e barazisë dhe transparencës të kërkuara nga Ligji për Prokurimin Publik.

Bazuar ne provat dhe faktet e prezantuara më larte, konsiderojmë se AK Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut ",, kushtet dhe specifikat i ka ne kundërshtim me ligjin për prokurim publik dhe me aktet tjera nënligjore.

Bazuar në provat dhe faktet e prezantuara, kërkojmë që dosja të korigjohet, duke përfshirë specifikimet teknike. Gjatë këtij procesi, kërkojmë që të sqarohen të gjitha pretendimet e ngritura nga ana jonë. Po ashtu, kërkojmë që të bëhen korrigjime të nevojshme në përputhje me kërkesat dhe rregullat e përcaktuara, për të mundësuar një konkurrencë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Kjo është në përputhje me parimet e barazisë dhe jo-diskriminimit, si dhe me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, për të siguruar një proces të drejtë dhe transparent.

VENDIM

- Te aprovohet si e bazuar, ne tërësi ankesa e OE - Dauti Komerc SH.P.K.;
- Dosja të korigjohet, duke përfshirë specifikimet teknike dhe te vlerësohet të gjitha pretendimet e ngritura nga Ne.

SHOQERI ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUARA DAUTI KOMERC SH.P.K. FERIZAJ

8. Dëmet materiale

Pjesëmarrja në këtë tender është bërë e pamundur për kompaninë tonë për shkak të kushteve dhe specifikimeve teknike të vendosura në dosjen e tenderit. Këto kushte e kanë kufizuar mundësinë për të konkurruar në mënyrë të barabartë me operatorët e tjerë ekonomikë dhe kanë çuar në mungesën e mundësisë për të marrë pjesë në këtë procedurë. Si pasojë e këtij diskriminimi, kemi humbur mundësinë për të fituar kontratën si dhe humbjen e mundshme të fitimit.

SHOQERI ME PERGJEGJESI TË KUFIZUARA * DAUTI KOMERC SH.P.K. * FIER